VENDIM
Nr.114, datë 27.2.2004

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË THIRRJES DHE PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHTETASIT, QË DO TË KRYEJNË SHËRBIMIN E DETYRUESHËM USHTARAK DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.65, DATË 2.2.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR THIRRJEN E SHTETASVE PËR SHËRBIMIN USHTARAK, AKTIV OSE NË REZERVË, KOMPLETIMIN E REPARTEVE USHTARAKE ME REZERVISTË, AUTOMJETE E TEKNIKË TJETËR, KAFSHË PUNE, SI DHE ORGANIZIMIN E SISTEMIT TË LAJMËRIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 34 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë" dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Bashkia apo komuna, ku shtetasi ka vendbanimin, detyrohet të lajmërojë dhe të sigurojë paraqitjen e shtetasit, që thirret për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, në qendrat e rekrutim-mobilizimit.

2. Pagesa, për çdo ditë-pune e korrierëve sezonalë për njoftimin e shtetasve për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv ose në rezervë, të jetë sa paga ditore e pagës minimale mujore, në shkallë vendi.

3. Aktivizimi i korrierëve bëhet me urdhër, me shkrim, të kryetarit të bashkisë, njësisë bashkiake ose komunës përkatëse, duke përcaktuar ditët e aktivizimit. Veprimet financiare për pagesën e korrierit kryhen pasi ai të ketë marrë konfirmimin e kryetarit të fshatit ose të administratorit të lagjes, në territorin e të cilit janë shpërndarë fletëthirrjet dhe nënshkrimin e shtetasit, që është njoftuar për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv ose në rezervë. Kur shtetasi që thirret për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak, aktiv ose në rezervë, ose familjarët e tij, nuk pranojnë ta nënshkruajnë njoftimin, bëhet shënimi në kopjen e fletëthirrjes, duke e nënshkruar, të paktën, edhe një dëshmitar. Në këtë rast njoftimi quhet i kryer.

4. Qendrat e rekrutim-mobilizimit, në bashkëpunim me bashkitë ose komunat, parashikojnë shpenzimet për pagesat e korrierëve, që realizojnë lajmërimin e shtetasve, në bazë të njësive vendore për çdo vit buxhetor, dhe i paraqesin ato në Ministrinë e Mbrojtjes.

5. Ministria e Mbrojtjes, me miratimin e buxhetit, bën ndarjen e hollësishme nga buxheti i vet në atë vendor, si transferta të kushtëzuara, për çdo bashki apo komunë, që do të kryejë pagesat për lajmërimin e shtetasve.

6. Pikat 1,2,3 dhe 4 të kreut II të vendimit nr.65, datë 2.2.1996 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

7. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano